



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN DHE
JASHTË
KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Nr. Q-25170/3 prot.

Tiranë, më 14/11/2022

Lënda: Kthim përgjigje

✓ QENDRËS "RES PUBLICA"

Bulevardi "Gjergj Fishta", godina 24, hyrja 3, ap. 7, Tiranë

I nderuar z. Matlija,

Pranë Bashkisë së Tiranës, bazuar në ligjin 119/2014 "Për të drejtën e Informimit" është paraqitur kërkesa juaj, e cila është protokolluar me nr. prot. Q-25170, datë 28.10.2022 dhe ka kaluar për shqyrtim te strukturat përkatëse, të cilat kanë kthyer përgjigje si më poshtë:

"Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit me shkresën me nr. prot. Q-25170/1, datë 10.11.2022 informon se, për të kryer një shqyrtim të saktë dhe për t'i dhënë përgjigje problematikës, nevojitet të na përcillni dokumentacion të plotë mbi pasuritë, pjesë përbërëse të pallatit nr. 19, rruga "Llambi Bonata", Njësia Administrative nr. 6, Tiranë".

Ndërkohë Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile me shkresën me nr. prot. Q-25170/2, datë 11.11.2022 bën me dije se, njoftimi i banorëve është bërë me datë 23.09.2021, në zbatim të vendimit të Këshillit Bashkiak me nr. 110, datë 02.08.2021 për demolimin e këtij objekti dhe referuar listës së familjeve (banorë të këtij pallati), të sjellë në email-in zyrtar nga Njësia Administrative nr. 6.

Sa më sipër, po ju informojmë se ky objekt është demoluar së fundmi dhe dokumentacioni tjetër i kërkuar prej jush është pjesë e dosjes që kompania, e cila ka kryer mbikqyrjen e punimeve si dhe ajo e kontraktuar për të realizuar procesin e demolimit do të depozitojnë pranë Bashkisë Tiranë, në përmbyllje të afatit kohor të përcaktuar në kontratë.

Bashkëlidhur një prej lajmërimeve të bëra një prej banorëve të objektit të sipërcituar".

Lutemi në dijeninë tuaj.

Me respekt

KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT





BASHKIA
TIRANË

BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E OBJEKTEVE NË BASHKËPRONËSI,
ADMINISTRIMIT TË NJËSIVE ADMINISTRATIVE
DHE EMERGJENCAVE CIVILE
DREJTORIA E EMERGJENCAVE CIVILE

Nr. 667/ prot.

Tiranë, më 23, 11, 2021

Lënda : Njoftim.

Z/ZNJ

Adresa: Pallati Nr. 19, Rruga "Llambi Bonata", Njësia Administrative Nr. 6, cel: 0672626711

Për dijeni : NJËSISË ADMINISTRATIVE NR. 6

TIRANË

I/E nderuar z/znj

Në kuadër të marrjes së masave për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore, Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 750, datë 27.11.2019 "Për shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore në Qarqet Durrës dhe Tiranë", për dëmet e shkaktuara nga tërmeti i datës 26.11.2019 Bashkia e Tiranës ka ndjekur procedurat për kryerjen e aktekspertizës së thelluar në objektet e dëmtuara, mbështetur në VKM Nr. 26 datë 15.01.2020 "Për kryerjen e Aktekspertizës së thelluar në ndërtesat e dëmtuara", Aktin Normativ Nr. 9 datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore".

Bazuar në verifikimet dhe akt konstatimet paraprake të Institutit të Ndërtimit, grupeve të punës së njësive administrative për dëmet e shkaktuara nga tërmeti i datës 26.11.2019 dhe rrezikun që paraqitej, është kryer aktekspertiza e thelluar për objektet e dëmtuara.

Për pallatin Nr. 19, Rruga "Llambi Bonata", Njësia Administrative Nr. 6 është kryer aktekspertiza e thelluar nga operator ekonomik të kontraktuar nga Bashkia e Tiranës mbështetur edhe nga opionenca teknike e Institutit të Ndërtimit, ku ekspertët kanë dalë në konkluzionin se pallati duhet të demolohej.

Me Vendim të Këshillit Bashkiak Nr. 110 datë 02.08.2021 është vendosur demolimi i detyruar i objektit, pallati Nr.19, Rruga "Llambi Bonata", Njësia Administrative Nr. 6.

Bashkëlidhur dokumentacioni.

Ju falenderoj për mirëkuptimin.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Aurel Çuko